REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT

PROJEKT-VENDIM

Nr.24, datë20/02/2026

PER MIRATIMIN E PLANIT OPERACIONAL 2026

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore"(I ndrushuar), nenit 15,17 të ligjit 111/2024 "Për disa ndyshime , te Ligjit Nr.9693 datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor" , nenit 21, pika 9, të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) , Ligji 57/2020 "Për Pyjet". Vendim nr. 398 , datë 13.5.2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të këshillit të ministrave, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive".

PROPOZOJ:

1. Miratimin e Planit Operacional pwr vitin 2026 , referuar Ligjit 57 / 2020 "Për Pyjet" Neni 3 , Pika 39 si dokument me rendesi te larte për planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve nga aktivitetet në pyjet publike, buxheti i shtetit, donacionet ose grantet e ndryshme për realizimin e punimeve të përcaktuara ose rekomanduara nga planet e mbarështimit, të veprimtarive për zhvillimin dhe mbrojtjen e fondit pyjor, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së nevojshme, si dhe për qëllime të tjera të parashikuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit pranë Bashkisë Devoll.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve në nenin 55 të Ligjit Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar

Konceptoi: Drejtor i Drejtorise te Pyjeve dhe Mjedisit

Edmir Cenolli

Konfirmoi: Pergj.Sek Juridik dhe Prokurimeve

Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISË

EDUARD DURO

Adresa: Lagj. Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 5; Tel+355811222288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com;
web:http://bashkiadevoll.gov.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

Plani Operacional për Pyjet dhe Kullotat 2026

Për administrimin e qëndrueshem te fondit

Pyjor/Kullosor



KONCEPTOI :

ING. Orgest Cenolli

ING.Antonio Kapshtica

MIRATOI : KRYETARI I BASHKISË

EDUARD DURO

PRANOI :

Drejtori i Drejtorisë të Pyjeve

EDMIR CENOLLI

Adresa: Lagj. Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 5; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com;
Web:http://bashkiadevoll.gov.al/

1.VIZIONI DHE QËLLIMI

Zhvillimi qëndrueshëm, nëpërmjet menaxhimit të pyjeve, kullotave dhe prodhimeve të dyta pyjore. i cili mbështetet nga infrastruktura e përmirësuar, aktivitetet e zhvillimit ekonomik dhe investimet e planifikuara, bazuar në bashkëpunimin e të gjithe aktorëve, transparencen e qeverisë lokale dhe mbështetjen e Komunitetit.

Rritja e të ardhurave nga burimet natyrore për komunitetin dhe ri-investimi i tyre në pyje e kullota, ulja e papunësise, rritja e mirëqënies dhe ruajtja e mjedisit.

Rëndesia e pyjeve është e gjithanshme dhe gjithëpërfshirëse, duke i bërë një element thelbësor të jetes sone. Perfitimet dhe impakti i pyjeve, sipas përdorimit të tyre, mund te kategorizohet në:

Sigurimi mbrojtjes për qeverisjen e qendrueshme dhe kontrollin e miradministrimit të fondit pyjor dhe kullosor brenda territorit administrativ të Bashkisë Devoll .

Plani Operacional hartohet bazuar në Objektivin kryesor të Politikës së Bashkisë Devoll, për një administrim të qëndrueshëm të Pyjeve dhe Kullotave Bashkiake duke përfshirë komunitetin e zonave pyjore, perdoruesit e Pyjeve e Kullotave të Bashkisë Devoll .

Ky Plan Operacional është një Plan Veprimi i cili ka një afat veprues 1 vit . Për cdo vit pasardhës ai i nënështrohet përditësimit me problemet e dala gjate rrjedhës së procesit kompleks të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve/kullotave Bashkiake.Rezultatet e pritëshme që do arrihen gjatë vitit 2026, do të specifikohen në kete plan.

Administrimi dhe Zhvillimi i Qendrushëm i Pyjeve Kullotave dhe burimeve të tjera dhe natyrore me origjinë Pyjore e Kullosore.

Krijimi i mundësive për gjenerim të ardhurash për komunitetin në përgjithësi për vetë banorët e zonave pyjore në veçanti.

Gjetja e mekanizmave për një mbrojtje më të mirë të fondit Pyjore dhe Kullosar nga prerjet ilegale dhe zëniet e perdorimin të kundraligjeshem të fondit Pyjor dhe Kullosor.

- **Plani Operacional ka si prioritet bazë përdorimin e metodave ligjore për gjetjen e mundesive per gjenerim te ardhurash për komunitetin e zonave pyjore ne Bashkinë Devoll.**

Trajtimi pyllit, shfrytezimi me prioritet i kullotave natyrore me shtrese barishtore dhe mbulese drunore, grumbullimit te bimeve medicionale etj, do te behet duke marre ne konsiderate tradicionalitetin e perdorur nga zona, e ne integrim te plote me rekomandimet e planeve te mbarshtrimit (menaxhimit) atje ku keto plane ekzistojnë dhe me Projekte Teknike atje ku keto Plane nuk ekzistojne .

Ne funksion te nje Menaxhimi dhe Administrimi me te mire e pyjeve dhe kullotave, perdorimi me efikasitet i burimeve njerezore, stafit teknik dhe jo vetem Identifikimin e problemeve bazë për zhvillimin e qëndrueshëm te pyjeve dhe kullotave .


2.OBJEKTIVA

- Të ndalohet degradimi i mëtejshëm i pyjeve dhe kullotave.
- Të rriten të ardhurat nga pagesat dhe tarifat në pyje.
- Krijimi i fondit të ri-investimit në pyje, kullota, prodhimet e dyta etj.
- Përmirësimi i gjëndjes dhe rritja e prodhimtarisë së pyjeve.
- Të ulet shkalla e erozionit.
- Të sigurohen kërkesat jetike të komunitetit për ngrohje dhe baze ushqimore për blegtorinë.
- Të rritet punësimi i komunitetit nëpërmjet punimeve.

3. PËRDORIMI AKTUAL I PYJEVE, KULLOTAVE DHE BURIMEVE NATYRORE


- **Përdorimi i Pyjeve**

Pyje me funksion prodhues		Pyje me funksion mbrojtes	
8045.4 ha	V= 264,744.2 m^3	2305.35 ha	V=10,723.3 m^3




- **Përdorimi i Kullotave**

Kullota te dobishme	Kullota te padobishme
2180.66 ha	934.57




***Sigurimi me dru zjarri per familjet dhe per entet e bashkise**

Sigurimi me dru zjarri per familjet	Sigurimi me dru zjarri per entet
119,150 mst	2,833.9 mst



***Mundesia vjetore e prodhimit te bimeve medicinale sipas Planeve te Menaxhimit Komunale**

Nr	Emërtimi	Sasia që Grumb Kv/vit	Mundësia për grumbullim Kv/vit
1	Dëllinjë e kuqe	12	15
2	Dëllinjë e zezë	5	7
3	Trëndafil i egër	20	40
4	Gjethe murizi	2	5
5	Herbe rigoni	3	4
6	Caj mali	2	3
7	Fruta kullumbrie	3	4
8	Dardhe e eger	12	25
9	Murriz Koker	12	27
10	Lule Murizi	4	8



**Shenim : Shumica e bimeve medicinale qe grumbullohen nga popullsia lokale , shitet ne subjektet qe bejne grumbullimin .*

4. AKTIVITETET KRYESORE DHE BILANCI I NEVOJAVE PËR MATERIAL DRUSOR


***Shfrytezimi i Pyjeve**

Pyjet ne Bashkine Devoll zene nje siperfaqe te konsiderueshme .Nder vite pyjet kane sherbyer nga popullsia si e vetmja mundesi per te siguruar dru zjarri dhe lende drusore . Bashkia Devoll ka bere furinizimin e enteve te saj nepermjet kontraktimit te nje subjekti të liçenensuar , nëpermjet nderhyrjeve të pastrim/rigjenerim , duke hequr druret me te meta dendrometrike , druret e rene/eroduar etj .

*Shfrytezimi i Kullotave

Kullotat e dobishme të Bashkisë Devoll (**2180.66 ha**) janë përdorur nga vite nga popullsia lokale për kullotjen e bagetive te tyre. Bashkia Devoll ka lidhur 1 kontrata me fermer I cili mbarshton bageti të imta dhe te trasha , duke dhene me qira nje sipërfaqe prej 108.92 ha . Gjithashtu Bashkia Devoll pasi vlersoi kerkesat e disa subjekteve të cilen investojne ne fushen e paneleve fotovoltaike ka lidhur 5 kontrata për dhenie me qira në fondin kullosor me siperfaqe 266 ha, si dhe 1 kontratë ne fushën e prodhimit të energjisë elektrike nga parku eolik me sipërfaqe ____ ..

***Shfrytëzimi: Gurore , Panele Fotovoltaike, Antena, etj.**




***Aktivitete turistike si: kampingje, ski etj.**

Zona e Devollit të Sipërm ka përqëndrimin më të madh të turisteve nga brenda dhe jashte vendit. Devolli mbetet për tu vizituar për vendet e bukura turistike, për rezervat natyrore të Cangonjit dhe Poloskën, për pyllin e Bradvicës,
Peisazhin e Nikolices, Shën Kostandinin si dhe për pamjen piktoreske që ofron Malit i Moravës dhe me plot burime ujore të tij.









Adresa: Lagj. Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 5; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com;
Web:http://bashkiadevoll.gov.al/

***Përllogaritje e detajuar e sasisës e materialit drusor (dru zjarri & lëndëndërtimi) që**
Nevojitet për komunitetin dhe për entet.
Burimet e sigurimit te këtyre nevojave, nga fondi i vet i bashkisë, pyjet Privat apo nga importi.

- **17,021 familje * 7 mst/familje = 119,150 mst / total**
- **2833.9 mst dru zjarri nevojiten për furnizimin e enteve të Bashkise Devoll**

Për shkak se Bashkia Devoll ndodhet ne zonen kontinentale me dimer te gjate dhe te ftohte dhe shumica e familjeve ndodhet ne fshat , përdorimi i druve të zjarrit për ngrohje është alternative për ngrohje . Kjo është nje sfide e madhe për Drejtorine e Pyjeve jo vetem për parandalimin e prerjeve ilegale por dhe sensibilizimin e kesaj popullsie .

6. BURIMET KRYESORE TË TË ARDHURAVE

Nr	Zërat kryesorë	Sasia	Vlera ne lek
1	Lëndë Punimi (Bllokuar /Sekuestruar)	-	-
2	Dru Zjarri (Bllokuar/Sekuestruar)	-	-
3	Kullota të dobishme (mbareshtim bagetish)	419.84 ha	302,500
4	Gjueti	-	-
5	Produkte Jodrusore (bime mjeksore,kuçka ,fashina)	-	-
6	Vlere dëmi dhe gjoba(Proçes Verbale)		
7	Dhenjë sipërfaqe në përdorim(Panele fotovoltaike)	266 ha	61,194,294
8	Të ardhurat nga kontratat konçensionare		
9	Shitje kredite karboni të sekuestraur (CO2)	-	-
10	Shitje kredite Oksigjeni i emetuar ne atmosphere (O2)	-	-
11	Vlera indirekte te pyjeve dhe kullotave nga rekreacioni	-	-
12	Te tjera specifiko (Fidanishte ,antene celulari,perdorim rruge pyjore dhe siperfaqe ndihmese)	5 km rruge+ 13 ha	2,050,910
TOTALI I TË ARDHURAVE NGA ,PYJET,KULLOTAT DHE REKREACIONI			63,547,704

7. PLANI I PUNIMEVE TË PARASHIKUAR

Nr	Zërat e Shpenzimeve	Vlera
	Pagat	11,514,253
	Sigurimet Shoqërore e shëndetsore	1,923,355
1	Shpenzime Operati	1,127,124
1.2	Të tjera	
1.3	Uniforma	-
1.4	Shpenzime per ZVRPP	60,000
1.5	Karburant	420,000
1.6	Servis dhe Pjese Kembimi	147,000
1.7	Siguracione dhe Kolaudim Automjeti	50,124
1.8	Blerje Pajisje Droni	450,000
2	Investime (a+b+c) Plan Mbarështrimi "3 Ekonomi Pyjore"	16,331,263
	a)Buxheti i shtetit	-
	b)Nga donatoret e ndryshem	-
	c)Nga llogaria e të ardhurave të bashkisë	16,331,263
2.1	Pyllëzime	-
2.2	Ngritje fidanishte	-
2.3	Zëvendësime në pyllëzime	-
2.4	Shërbime kulturale në pyllëzime	-
2.5	Ricungime , prerje kulturale (përmirësime pyjesh)	-
2.6	Mbrojtje nga zjarret	-
2.7	Luftim sëmundje dhe dëmtuesish	-
2.8	Mirëmbajtje rrugësh autopyjore	-
2.9	Riparime lerash	-
2.10	Sistemime malore , punime kundër erozionit	-
2.11	Përmirësim kullote dhe lera (1 ha)	-
	TOTALI I SHPENZIMEVE	30,895,995

8. PLANI I PUNIMEVE PËR PUNIMET EMERGJENTE

Aktivitetet	Reziqet Potenciale	Probabiliteti që mund të ndodhë	Impakti në Planifikim	Masat për zbutje
Masat në kuadër të planit operacional	Emergjenca të ndryshme	Ulët	Lartë	Burime financiare për emergjenca të ndryshme
	Mungesa e fondeve	I Ulet	Lartë	Gjetja e burimeve financiare
	Mungesa e PMPK	I Mesem	I Mesem	Hartimi PMPK për të gjitha ekonomitë
	Kushtet ekstrem të motit	Ulët	Lartë	Vrojtimi i Kushteve të motit
	Cmimet e pafavorshme të produkteve në treg	Mesatar	Mesatar	Të dhënat historike për çmimet e tregut
	Të dhëna të pasakta mbi burimet në pyje dhe kullota	Lartë	Lartë	Monitorim periodik I burimeve pyje/kullota
	Niveli professional i stafit	Mesatar	Mesatar	Trajnime të stafit

9. BURIMET E FINACIMIT TË PUNIMEVE

	TË PUNËSUAR NË SEKTORIN SHTERËROR	Total punësuar
I	Totali në sektorin shtetëror (A+B+C+D)	14
II	Drejtori I Drejtorisë	1
A	administratë e shërbimit pyjor (1+2+3)	4
1	me arsim të lartë	4
2	të tjerë	-
3	punonjës shërbimi në pyje e roje	6
B	Inspektoriati i mbrojtjes së pyjeve (3+4)	3
4	Me arsim të lartë	4
5	Shofer	-
C	Ndermarje të prodhimit të lëndës drusore të bashkisë,etj	-
D	Institucione të tjera , kërkimore,shkencore etj	-
	GJITHSEJ TË PUNËSUAR	14

Adresa: Lagj. Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 5; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com;
Web:http://bashkiadevoll.gov.al/

Administrimi, Menaxhimi dhe trajtimi i pyjeve dhe kullotave do të behet në menyrë të qëndrueshme me synim rritjen e produktivitetit dhe të funksioneve të tjera të Pyjeve dhe Kullotave. Per kete janë identifikuar problemet kryesore që lidhen me situaten aktuale të tyre

3.2. Analiza e situatës aktuale në Pyje dhe Kullota të kaluara në pronësi të Bashkisë Devoll

Mbi bazen e identifikimit te problemeve për situatën aktuale, do të bëhet analiza e treguesve sasior dhe cilësore, nepermjet te cileve identifikohen më mirë pikat e forta dhe te dobëta të kushteve, që aktualisht ndikojnë në menaxhimin dhe administrimin e Pyjeve dhe Kullotave dhe që domosdoshmerisht kërkojnë një vëmendje më të madhe për përmirësimin e tyre në funksion të menaxhimit të qendrushëm të Pyjeve dhe Kullotave.

3.1 Gjatë vitit 2026, Drejtoria e Pyjeve do të ketë si objektiva kryesore:

- Ndjekjen dhe zbatimin e plotë të Planit të Menaxhimit të Pyjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe politikat kombëtare për mbrojtjen e mjedisit.
- Ruajtjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor si prioritet kryesor, duke synuar parandalimin e dëmtimeve, shfrytëzimit të paligjshëm dhe degradimit të sipërfaqeve pyjore.
- Menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore, duke siguruar që përdorimi i tyre të bëhet me kritere të qarta teknike, mjedisore dhe ligjore, pa cenuar kapacitetet rigjeneruese të pyjeve.
- Rritjen e kontrollit dhe monitorimit në territor, përmes inspektimeve të rregullta dhe bashkëpunimit me strukturat përgjegjëse, me qëllim garantimin e zbatimit korrekt të planit të menaxhimit.
- Forcimin e masave për mbrojtjen nga zjarret në pyje, dëmtuesit dhe faktorë të tjerë rreziku, duke përfshirë masa parandaluese dhe ndërhyrje të shpejta në rast nevoje.
- Ndërgjegjësimin e komunitetit dhe përdoruesve të burimeve pyjore mbi rëndësinë e ruajtjes së fondit pyjor dhe përdorimin e tij të përgjegjshëm dhe të kontrolluar.
- Përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional për menaxhimin dhe mbrojtjen e fondit pyjor, me synim rritjen e efektivitetit të masave të ndërmarra gjatë vitit 2026.

Mekanizmat që do të përdoren.

Për rritjen e kapaciteteve te teknikeve nepermjet trajnimit te tyre. Ndergjegjesimi banoreve te zonave pyjore, shoqatave te perdoruesve etj, mbi nderhyrjet ne fondin pyjor duke rritur kapacitetet menaxhuese, mbrojtese dhe administruese te perdorueseve të pyjeve

Nepërmjet përdorimit të trajtimit dhe shfrytëzimit të kapaciteve prodhuese, do të punohet me subjekte të specializura, shoqatat e përdorueseve të pyjeve për mitjen e të ardhurave ekonomike që do të lehtesojne barren financiare që duhet për kete administrim dhe menaxhim të qëndrushëm

Drejtimet e punimeve do të jenë:

Per lenden drusore dhe prodhimet e tjera pyjore e nevojiten për plotesim të nevojave, do te behet e përqendruar në bazë fshati sipas nevojave për familje sipas planeve te menaxhimit, në zbatim te ligjit e akteve nenligjore dhe nën drejtimin e kontrollin e teknikëve dhe specialisteve të Drejtorise te Pyjeve .

Qëllimi kryesor i menaxhimit të pyjeve do të jetë **konservimi i fondit pyjor**, si një domosdoshmëri për garantimin e ruajtjes afatgjatë të burimeve natyrore dhe mbrojtjen e ekosistemeve pyjore. Në kushtet aktuale, deri në përfundimin e procesit të hartimit dhe miratimit të planeve të reja të menaxhimit të pyjeve, fokusi kryesor i veprimtarisë së Drejtorisë së Pyjeve do të përqendrohet në mbrojtjen, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e fondit ekzistues pyjor.

Gjatë vitit 2026, menaxhimi i pyjeve do të orientohet drejt kufizimit të ndërhyrjeve shfrytëzuese dhe drejt zbatimit të masave konservuese, me qëllim parandalimin e degradimit të sipërfaqeve pyjore dhe ruajtjen e kapaciteteve natyrore rigjeneruese të tyre. Çdo përdorim i burimeve pyjore do të realizohet vetëm në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe me kritere të qarta teknike dhe mjedisore, duke u bazuar në parimin e qëndrueshmërisë dhe përgjegjshmërisë ndaj mjedisit.

Në këtë periudhë tranzitore, deri në përfundimin e planeve të reja të menaxhimit, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet rritjes së masave të mbrojtjes së fondit pyjor nga shfrytëzimi i paligjshëm, prerjet e pakontrolluara, zjarret në pyje, si dhe nga dëmtimet e shkaktuara nga faktorë natyrorë apo njerëzorë.
Drejtoria e Pyjeve do të intensifikojë kontrollet dhe monitorimin në terren, duke forcuar bashkëpunimin me strukturat përkatëse dhe institucionet përgjegjëse, për të garantuar respektimin e rregullave të menaxhimit dhe mbrojtjes së pyjeve.

Një tjetër element thelbësor i menaxhimit gjatë vitit 2026 do të jetë ruajtja e biodiversitetit pyjor dhe funksioneve ekologjike të pyjeve, duke marrë parasysh rolin e tyre në mbrojtjen e tokës nga erozioni, rregullimin e regjimit ujor, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ruajtjen e ekuilibrave natyrorë. Në këtë kuadër, do të zbatohen masa parandaluese dhe ndërhyrje minimale, të orientuara drejt stabilizimit të gjendjes së fondit pyjor dhe përgatitjes së kushteve të nevojshme për menaxhim të qëndrueshëm në vitet në vijim.